



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr. 61/2016

**PËR SHPALLJEN E MORATORIUMIT TË GJUETISË
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ndalimi i ushtrimit të aktivitetit të gjuetisë, me qëllim përmirësimin e gjendjes së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie.

Neni 2

Objekti dhe fusha e veprimit

Ky ligj përcakton rregullat që do të zbatohen gjatë ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë së gjuetisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

**Pezullimi i përdorimit të zonave të gjuetisë dhe pezullimi i gjuetisë në zonat
e mbarështimit të faunës së egër**

1. Përdorimi i zonave të gjuetisë, të dhëna për këtë qëllim nëpërmjet ofertës publike, sipas legjisllacionit në fuqi për gjuetinë, pezullohet.

2. Kontratat për mbarështimin e faunës së egër janë të vlefshme, por edhe në këto zona, ku mbarështohet fauna e egër, nuk mund të ushtrohet gjuetia deri në afatin e zbatimit të këtij ligji.

Neni 4

Përfshirja nga fusha e veprimit

1. Përfshihen nga fusha e zbatimit të nenit 2 të këtij ligji:
 - a) gjuetia në rastet e konstatimit të mbipopullimit të një lloji të faunës së egër, në zonat e lejuara për gjueti dhe në rezervatet e mbarështimit, sipas legjislacionit në fuqi për gjuetinë;
 - b) gjuetia për qëllime kërkimore-shkencore.
2. Përfshirja, i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 5

Afati i zbatimit

Afati i zbatimit të këtij ligji është pesë vjet, nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 6

Sanksionet

1. Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
 - a) kur shkelja kryhet e organizuar nga operatorët e tureve të gjuetisë, shoqatat e gjuetarëve ose federatat e gjuetarëve, subjekti që e organizon dënohet me gjobë në masën 800 000 (tetëqind mijë) - 1 000 000 (një milion) lekë;
 - b) kur shkelësi është një individ ose është individ, pjesëtar i subjekteve organizuese, sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, dënohet me gjobë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) - 100 000 (njëqind mijë) lekë.
2. Në rastet e përsëritjes së shkeljes, nga subjektet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, përveç dënimit me gjobë, vendoset si dënim plotësues edhe heqja e lejes së gjuetisë, si dhe konfiskimi i armës së gjahut.
3. Shqyrtimi i kundërvajtjes bëhet nga inspektorati shtetëror përgjegjës për gjuetinë. Vendimi i dënimit, ankimi kundër tij dhe ekzekutimi i dënimeve me gjobë bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 253, datë 11.3.2010, “Për gjuetinë”, të ndryshuar.

Neni 7

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit

Ngarkohen Ministri i Mjedisit, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Financave, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve për zbatimin e këtij ligji.

Neni 8

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të këtij ligji.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ilir META

Miratuar në datën 2.6.2016